REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**
**SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE**

**Nr.1345 Prot.** **Patos, më 17/05/ 2024**

**MIRATOHET**
**KRYETARI**
**Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

**Nr. 44, datë 17/05/2024**

**PËR NDARJEN E KATEGORIVE TË BANESAVE NË ZBATIM TË VKM NR. 179, DATË 26.02.2020**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në zbatim të gërmës "n"të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, në zbatim të VKM nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurave të privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarjeve shtetërore" pika 21, paragrafi i fundit i VKM së sipërcituar (Ndarja e banesave sipas kategorive bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore) i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratoj:

1. Për efekt privatizimi, banesa të kategorisë së parë, vlerësohen banesat që ndodhen në rrugën kryesore (banesat që ndodhen në Shëtitoren Republika).
2. Banesa të kategorisë së dytë do të vlerësohen, banesat që ndodhen brenda unazës së qytetit, duke përjashtuar banesat e pikës së parë.
3. Banesa të kategorisë së tretë do të vlerësohen banesat që ndodhen në periferi të qytetit, ku përfshihen (zona industriale transport, fshatrat në juridiksion të bashkisë Patos), si dhe banesat që kanë probleme teknike.

**GRUPI I MENAXHIMIT**

Sokol **Meta** Ina **Sauli** Mimoza **Shtëmbari** Arben **Semanjaku**

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Elda **Goxhaj** Juela **Shpata** Astrit **Murati** Ermenita **Mici**

Erion **Hatia** Orges **Golloshi** Alket **HALIMI** Eneo **Xhaferi**

Arben **Shpërdheja** Endrit **Çako** Armando **Gushi** Florian **Kita**

Blerina **LAÇI** Barie **Goxhaj** Nurkë **Hazizaj** Lindita **Pepa**

Adm. Njësia Administrative Zharrëz

Riza **Hoxha**

Adm. Njësia Administrative Ruzhdije

Agim **Mesutaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA PATOS

## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
## SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE

**Nr.1345/1 Prot.** **Patos, më 17/05/ 2024**

# RELACION

## PËR NDARJEN E KATEGORIVE TË BANESAVE NË ZBATIM TË VKM NR. 179, DATË 26.02.2020

Në zbatim të VKM nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurave të privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarjeve shtetërore" pika 21, paragrafi i fundit i VKM së sipërcituar (Ndarja e banesave sipas kategorive bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore), ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Urdhërit nr. 223, datë 12.12.2023 të Kryetarit të bashkisë "Për krijimin e komisionit të privatizimit të banesave" në mbledhjen e tij, diskutoj mbi procedurën e privatizimit të banesave që figurojnë të paprivatizuara, sipas VKM nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurave të privatizimit të banesave. Në pikën 21 të këtij vendimi thuhet "Për efekt privatizimi, sipas këtij vendimi banesa të kategorisë së parë vlerësohen banesat që ndodhen në rrugën kryesore. Ndarja e banesave sipas kategorive bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komisioni në propozimin e tij është bazuar dhe në një Vendim të mëparshëm të Këshillit Bashkiak me nr. 85, datë 17.09.2008. sipas VKM nr. 97, datë 03.02.2008, "Për procedurat e banesave shtetërore" i ndryshuar me daljen e VKM nr. 179, datë 26.02.2020.

**KOMISIOMI I PRIVATIZIMIT**

Kryetar
Sokol Meta

Anëtar
Arben Shpërdhea

Anëtar
Andi Kola

Anëtare
Anisa Kripa

Anëtare
Nurkë Hazizaj

**KRYETARI**
**Fation Duro**